



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.4.2023

Nr: 406

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË KONGRESIT TË AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE TË KËSHILLIT TË EUROPËS, TË MISIONIT TË OSBE-ODIHR, KONTESË SË L.A DHE KQZ E REPUBLIKËS SË KIRGISTANIT, PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 25.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës me seli në Strasbourg ;
Misioni i OSBE-ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve me seli në Varshavë, me përfaqësues znj. Audrey Glover;
Kontea e L.A me përfaqësues z. Dean.C Logan;
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kirgistanit me përfaqësues z. Shaildabekova Nurjan Karamabekovna
- OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 25.4.2023 Nr: 406
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, të Misionit të OSBE-ODIHR, Kontesë së L.A dhe KQZ e Republikës së Kirgistanit, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

V Ë R E J:

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 20 (njëzetë) vëzhgues afatgjatë dhe 10 (dhjetë) përkthyes si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës është një organ konsultativ, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Misioni i OSBE-ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 34 (tridhjetë e katër) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Misioni i OSBE-ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Kontea e L.A i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Kontea e L.A është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kirgistanit i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kirgistanit është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 20 (njëzetë) vëzhguesve afatgjatë dhe 10 (dhjetë) përkthyesve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 25.4.2023 Nr: 406
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, të Misionit të OSBE-ODIHR, Kontesë së L.A dhe KQZ e Republikës së Kirgistanit, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Akreditimin e 34 (tridhjetë e katër) përkthyesve të Misionit të OSBE-ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Kontesë së L.A, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kirgistanit, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI